

Në bazë të nenit 27 të Ligjit për standardin e nxënësve (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”nr. 52/2005, 117/2008, 17/2011, 135/2011, 15/2013, 41/2014, 146/2015, 30/2016, 64/2018 dhe 20/2019 dhe “ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut “ nr. 248/2020 dhe 302/2020).

Rregullores për mënyrën dhe procedurën për pranimin e nxënësve në konviktet publike për nxënës (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 55/10, 49/11, 50/15, 59/16, dhe 41/17) dhe Rregulloren për mënyrën e realizimit të drejtës për akomodim në konviktet për nxënës për nxënësit e akademisë sportive nr. 20-6066/1 të datës 22.03.2016 Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall

## **KONKURS**

### **për ndryshim dhe plotësim të Konkursit për pranimin e nxënësve në konviktet publike për nxënës në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin shkollor 2021/2022**

Në Konkursin për pranimin e nxënësve në konviktet publike për nxënës në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin shkollor 2021/2022 nr. 19-5376/1 të datës 25.03.2021 në pjesën II. MËNYRA DHE AFATI I APLIKIMIT paragrafi dy ndryshohet dhe thotë: “ Nxënësit të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit plotësojnë fletëaplikim elektronik dhe e bashkangjesin dokumentacionin përkatës në <http://e-uslugi.mon.gov.mk>, ndërsa nëse nuk kanë mundësi të aplikojnë në formë elektronike, plotësojnë fletëaplikimin në letër (listë evidentuese) dhe e dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm sipas Konkursit për konviktin e nxënësve”.

Paragrafi pesë ndryshohet dhe thotë:

“ Nxënësit të cilët në Konkurs do të aplikojnë në formë të letrës, dokumentacionin e kompletuar e dorëzojnë prej datës 04.07.2021 deri më 15.07.2021, në konviktin për nxënës të cilët kanë aplikuar për akomodim”.